

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E HËNË 23 MAJ 2022

Në shekullin e XVIII-të, Rasini, një autor francez i tragjediave klasike, zgjodhi Butrintin për të shkruar historinë tragjike të Andromakës, Robinja e mbretit të Epirit Antik, pallatet e të cilit Rasini i përshkruan si vendet e dashurisë së çmendur dhe të tragjedisë pasionante, por edhe të intrigave e ligësive pa fund. Duket se Butrinti, historia e të cilit daton 800 vjet para Krishtit, e ka pasur zemrën plot me magjepsje që në krye të herës në gjurmët ilire, por edhe në periudhën helene, romake, bizantine dhe osmane, sepse qytetërimi kudo ndërtohet mbi bazën e kryqëzimeve të kulturave, feve, gjuhëve dhe njerëzve që kalojnë në territor.

Në shekullin e XVII-të Butrinti magjepsi publikun përmes tragjedisë së Andromakës, ndërsa në vitet 2020-2022 shumë gjëra kanë ndryshuar, por pasionet dhe sherret jo. Kjo ndodh gjithmonë me thesaret, sepse e pranojmë të gjithë që Butrinti është një thesar, xhevahir i kurorës së trashëgimisë kulturore dhe si i tillë, në vitin 1999 u regjistrua, u pranua si siti i parë shqiptar i përfshirë në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Të nderuar kolegë,

Qyteti antik i Butrintit përbën një peizazh kulturor, por edhe natyror të jashtëzakonshëm. I ftoj ata që nuk e kanë vizituar ende, dhe janë të shumtë, meqenëse flasim për të, të shkojnë në Butrint. Peizazhi i Butrintit është i zhvilluar në mënyrë të natyrshme përgjatë shumë shekujsh, duke i shpëtuar ndërkohë, për fatin e mirë të tij dhe tonit, zhvillimit agresiv që ka reduktuar vlerat e trashëgimisë kulturore, sikurse ka ndodhur rëndom edhe në Shqipëri në këto vite tranzicioni, por edhe në shumë site historike të Mesdheut. Mjafton të shikoni Cartagena-n për të kuptuar çfarë ka ngelur ndër shekuj prej saj. Ky sit përbën një rast shumë të rrallë të kombinimit të arkeologjisë dhe të natyrës, ndaj Butrinti ka statusin e dyfishtë të Parkut Kombëtar Kulturor dhe Natyror, ruhet, mbrohet, begatohet nga dy ministri, e Kulturës dhe Mjedisit, ose, në qeveri të ndryshme, nga ministria përgjegjëse për Trashëgimisë Kulturore dhe ajo për Zonat e Mbrojtura.

Butrinti është një thesar dhe si të tillë duam ta tregojmë, por edhe ta begatojmë, që të vazhdojmë ta tregojmë në breza. Tani është momenti për t'i dhënë me qetësi përgjigje disa pyetjeve, dilemave, sulmeve të bëra rëndom drejt Butrintit. Si e gjetëm në vitin 2013? Pa plan menaxhimi, me vegjetacion të

pakontrolluar, me shumë nevoja për restaurime dhe mirëmbajtje muresh, me biletari elektronike të instaluar në vitet 2011-2012 falë kontributit të të njëjtit fondacion shqiptaro-amerikan për zhvillim, por administrata e asaj kohe nuk dinte apo nuk donte ta vinte në punë, me shërbime mjerane ose pa shërbime.

Nuk bëmë një plan menaxhimi që në vitin 2013, sepse mësuam se përpjekjet e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, për të bërë një të tillë me administratën para vitit 2014, nuk kishin rezultuar të suksesshme; plani i fillimit të viteve 2000 e kishte mbyllur afatin e vet dhe nuk i përgjigjej natyrisht nevojave të sitit, sepse planet e menaxhimit janë me afate; nevoja për ndërhyrje emergjente ishte e domosdoshme, duke filluar nga pikat sanitare deri te shtigjet, te mirëmbajtja e mureve të kalave dhe të kullave, te konservimi i mureve rrethues, te zgjerimi i biletarisë ekzistuese, te kontrolli i të ardhurave, te ndërhyrjet infrastrukturore të domosdoshme për sitin, te disiplinimi i ujërave të parametrave të sigurisë për vizitorët që shtoheshin, por edhe të kujdesit ndaj vizitorëve, përfshirë edhe kushte dinjitoze të shërbimit pa cenuar trashëgiminë, pa cenuar arkeologjinë në përputhje me të gjitha rregullat dhe ligjet e shtetit shqiptar dhe rekomandimet e UNESCO-s, me të cilët jemi konsultuar në çdo hap.

Për të qenë e qartë, këtu e kam fjalën edhe për qendrën e vogël multifunktionale, që në vitin 2008 u kthye për pak kohë në kafene nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, që drejtohej atë kohë nga ulëritësit e sotëm, por ndonëse në arkivat e Ministrisë së Kulturës figuron me emrin “kafeteri”, ishte një barakë plehrash dhe qelbësillëqesh të mbushura plot. Kurse, në hyrje të parkut shiteshin akullore me kazan dhe byrek me tepsi, gota e ujit shitej 3 mijë lekë në 40 gradë, si të ishte shampanjë, pa folur për shërbimin e ujit, që Parku ia blinte çdo vit restaurantit aty afër, që ngjante me burimin që e mbante kuçedra. Flisni ju për menaxhim?! Ne nuk bëmë gjë tjetër, veçse e kthyem barakën e plehrave në një pikë pushimi dhe informacioni të vogël, por dinjitoze.

Çuditësisht, pas të gjitha britmave dhe klithmave me baltë nga ata që e shikojnë Butrintin si mollë sherri, çështje pasioni, e pranoj, ose nga ata që nuk e shikojnë fare, se as nuk e dinë ku bie Butrinti, madje me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave në vitet 2008- 2009, copa të qytetit antik ua kanë dhënë pronarëve privatë, që sot e kësaj dite kanë një tapi në dorë. Flisni ju për menaxhim?! Flasin edhe ata, që injorancën e kanë të vetmen anë mjerane që u ka mbetur për protagonizmin e dëshmëruar ose karrierën e munguar, por kurrsesi jo si pasuri kulturore dhe akses dinjitoz kulturor për publikun. Thanë e çfarë nuk thanë, por askush nga disa qindra mijë vizitorë, që kanë frekuentuar Parkun në këta vjet, nuk u ankuan, nuk e kritikuan, nuk anatantuan për shërbimet në Parkun e Butrintit, përkundrazi, balta humbet dhe u mbetet sherrxinjve dhe smirëzinjve. Do të ishte mirë që çdokush, para se të flasë, t’i japë 3 orë

kohë nga jeta e vet dhe ta vizitojë të plotë Butrintin, sepse aq zgjat nëse do ta bësh me pak nxitim të gjithë itinerarin. Uroj t'ia jepni 3 orë kohë Butrintit për kënaqësinë tuaj dhe të fëmijëve tuaj.

Gjithashtu, ka profesionistë të vërtetë që i kanë dhënë dije dhe kulturë, sikurse është profesori, akademiku, Richard Hodges, me karrierë të shquar shkencore në botën europiane dhe atë amerikane të shkencës, që marrëdhënien me Butrintin e ka që në vitin 1993, ku të dy lordët e nderuar, Rothschild dhe Sainsbury, i kërkuan të bëhej drejtori shkencor i fondacionit që ata krijuan, fondacionit të parë të Butrintit, edhe pse profesor Hodges ka kontribute më tepër sesa kaq, President Emeritus i Universitetit Amerikan në Romë, që e drejtoi në vitet 2012-2020 dhe në vitin 2015, jo qeveria, jo politika, por bota e shkencës arkeologjike shqiptare i dha titullin “Profesor nderi i arkeologjisë shqiptare” edhe për Butrintin, sepse kontributi i tij është i dokumentuar, bashkë me ekspertët më të mirë shqiptarë të arkeologjisë në kushedi se sa revista shkencore ndërkombëtare prestigjioze, por jo më pak të rëndësishme dhe me një seri monografie me 9 vëllime, dedikuar Butrintit, botuar nga Oxbow Books e Oksfordit, duke e bërë Butrintin një nga qendrat arkeologjike më të studiuara dhe më të promovuara në Mesdhe.

Ky është profesori Richard Hodges, të cilin të paktën duhet ta falënderojmë që vazhdon pasionin, se e thashë që në fillim, sherr dhe pasion, ai vë pasionin në shërbim të Butrintit! Me kaq e quaj të mbyllur këtë histori banale të mejhaneve politike dhe të makinës së baltës, me të cilën përballemi prej vitesh, sa herë ndërmarrim një nismë të re për ndryshim. Sherre e shamata kur nisëm Pazarin e Korçës, sherr e shamata kur restauruam Pazarin e Gjirokastrës, por kënaqem kur shkoni me familjet tuaja në Gjirokastrë për të kaluar fundjavën, jeni të mirëseardhur; sherr e shamata kur bëmë stadiumin e ri; sherr e shamata kur bëmë muzeun “Marubi”, muzeun e Gjethit; Muzeun e Artit Mesjetar, rijetëzimin e kalasë së Tiranës; sherr e shamata kur nisëm Teatrin e Operas dhe Baletit; pa folur për kishat e xhamitë e restauruara, pa folur për qindra objekte dhe asnjë fjalë për faktin se, para se të nisim gjithë këto kantiere, kantieri i fundit muzeal i ndërtuar në vend ishte ai i vitit 1981, Muzeu Historik Kombëtar.

Që të kuptojmë se për çfarë flasim: shikoni këtë publikim të Ministrisë së Kulturës në vitin 2017, është katalogu i objekteve të humbura për periudhën 1991-2016, ku 2249 objekte deklarohen të humbura nga fondet, koleksionet publike të muzeve. Humbjet e fundit janë shënuar në vitin 2012. Ky është numri i objekteve të humbura, që ne kemi arritur të identifikojmë pas investigimeve tona. Madje, nuk do ta besoni, por as koleksioni i Muzeut Historik Kombëtar nuk ishte i regjistruar. Detyra e parë për çdo shtet është të dokumentojë pasuritë e veta, sidomos pasuritë kulturore. Në vitin 2014 trashëguam një situatë pa situatë, gjatë dy vjetëve i ramë kryq e tërthor Shqipërisë, gur më gur, për të bërë inventarin e plotë të

trashëgimisë kulturore, se na kishte ngelur vetëm ai i viteve '80. A e dini se mbi 100 objekte nga ajo listë nuk ekzistonin më fare, ishin fshirë nga faqja e dheut dhe askund të dokumentuara?

Si mund të ishte ndryshe, kur askush nuk i kishte vizituar, aq sa kishave u kishin mbirë pemët brenda dhe u kishin dalë mbi çati, si në Rehovë, në Dropull, në Delvinë, apo grabiteshin në mes të ditës, siç ishte rasti me ikonostasin e kishës së Shën Mërisë në Voskopojë në vitin 2009, pa folur për gjendjen e mjerë të thesareve të Marubit, të Muzeut të Ikonave, që i kishte ngrënë lagështira. Ku jemi sot? në këta nëntë vjet janë bërë shumë punë në kulturë, kemi hartuar e miratuar një ligj në vitin 2018, që na bën krenarë, që për më tepër opozita në komisionin përgjegjës në votimin në parim, ku bënte pjesë edhe koncepti i administrimit indirekt, që prodhon një marrëveshje si kjo që propozohet sot, e votoi 100%.

Administrimi indirekt është forma e fondacionit kulturor joprivat. Ja ku e kam ligjin “Për trashëgiminë kulturore”, në asnjë faqe dhe asnjë rresht nuk e gjeni fjalën “koncesion”, që e hidhni pa qeder vend e pa vend, as edhe një rresht, sepse trashëgimia kulturore, madje edhe arkeologjia, edhe sikur të jetë në tokë private, është pronë publike me ligj. Shembuj? Arena e Veronës, teatri “Orange” në Francë, hapini, se do t’i gjeni.

Përpara se ta mbyll, ju ftoj ta votojmë këtë marrëveshje. Dua të falënderoj këdo që nuk ka lënë gjë pa thënë kundër projekteve që kemi realizuar në kulturë gjitha këto vite, sepse ka provuar se sa shumë punë kemi bërë dhe se si ia kemi dalë ta bëjmë kulturën temë të ditës! Edhe një korrektim të vogël gjuhësor: në shqip thuhet Butrinti ynë, jo Butrinti jonë.